

Vendim nr. 139 datë 21.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 21.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Th) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: THOMAS DHIMOLEA

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përsheptimi i procedurave.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Thomas Dhimolea ka qenë në cilësinë e palës paditëse në një proces civil me institucionin e arsimit të lartë “P.”, për mospajisjen me diplomë konform rregullave në fuqi. Gjatë këtij procesi, shtetasi M.S., përfaqësues i këtij institucioni, i është drejtuar kërkuesit me thënie të

pavërteta dhe fyese, fakt për të cilin kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt “*Shpërblim dëmi jopasuror prej 800 mijë lekësh*”.

2. Me vendimin nr. 383, datë 05.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: “*Pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurit M. S. të shpërblejë në masën 800.000 (tetëqind mijë) lekë paditësin Thomas Dhimolea për dëmin e shkaktuar.*”.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 436, datë 11.12.2019, ka vendosur: “*Prishjen e vendimit gjyqësor civil nr. 383, datë 05.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me një tjetër trup gjykues*”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs palët në gjykim.

4. Me kërkesën e datës 08.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjykimit. Në kërkesë kërkuesi ka pretenduar se nga momenti i regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Lartë në datën 24.09.2020 është tejkaluar afati 2-vjeçar i parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i Kodit të Procedurës Civile (KPC) për shqyrtimin e çështjes nga kjo gjykatë.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 22, datë 15.12.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Sipas këtij kolegji, mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjithashtu, gjyqtari relator aktual ka realizuar edhe një praktikë sesi merr në shqyrtim çështjet për të cilat është në cilësinë e relatorit dhe shqyrtimi i tyre bëhet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Kolegji Penal, duke pasur në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së në lidhje me çfarë përbën sjellje të gjykatës që ndikon në cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, ka vlerësuar se rastet kur gjykata është në pamundësi objektive për të gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë, shkurtimit të numrit të gjyqtarëve në sistem, nuk përbëjnë cenim të këtij standardi (*shih paragrafin 23 të vendimit të Kolegjit Penal*).

6. Me kërkesën e datës 11.04.2023, e cila është plotësuar në datën 27.04.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi** ka parashtruar se është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi nga momenti i regjistrimit të rekursit në datën 24.09.2020 është tejkaluar afati 2-vjeçar i parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së. Në rastin konkret sjellja e kërkuesit dhe sjellja e autoriteteve nuk përbëjnë shkak për

zvarritjen e gjykimit si dhe çështja nuk paraqet kompleksitet të veçantë. Pamundësia objektive në lidhje me ngarkesën e gjykatave nuk mund të jetë rrethanë për justifikimin e kohëzgjatjes së gjykimit, qëndrim i mbajtur edhe nga Gjykata në vendimin nr. 2, datë 17.02.2022.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në objektin e ankimit kushtetues individual kërkuar ka pretenduar vetëm konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, por, në thelb, ai kundërshton edhe vendimin nr. 22, datë 15.02.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij, në kuptim të dispozitave të neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Për rrjedhojë, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuar legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Kriteri për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuar, të cilët përpara se t’i drejtohen Gjykatës duhet të vërtetojnë se kanë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta

për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Me ndryshimet që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 38/2017*), të cilat hynë në fuqi në datën 05.11.2017, u përcaktua se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), llojet e mjeteve për t’u mbrojtur nga cenimi, si kërkesa për përshpejtimin e procedurave (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe çfarë konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7) deri tek marrja e vendimit dhe zbatimi i tij (nenet 399/8 – 399/12). Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm.

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pas vendimit të Gjykatës së Apelit, e cila ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, palët ndërgjyqëse kanë ushtruar rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 24.09.2020. Në datën 08.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit, bazuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 22, datë 15.02.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuetit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës me ankim kushtetues individual.

13. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është i datës 15.12.2022. Në kushtet kur kërkesa me këtë objekt është paraqitur në Gjykatë në datën 11.04.2023 dhe për sa kohë që shkelja në lidhje me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm është vazhduese, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

14. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të rekursit të tij nga Gjykata e Lartë. Kjo kërkesë është në funksion të gjykimit të mosmarrëveshjes së themelit me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror, gjykim i cili është kthyer nga Gjykata e Apelit Vlorë për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Për rrjedhojë, në referim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e shqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së gjykitimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi nga momenti i regjistrimit të rekursit në datën 24.09.2020 kanë kaluar 2 vjet e katër muaj, gjë që është në kundërshtim me nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, i cili parashikon se afat i arsyeshëm i përfundimit të gjykitimit për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë do të konsiderohet afati dyvjeçar. Në rastin konkret sjellja e kërkuesit dhe sjellja e autoriteteve nuk përbëjnë shkak për zvarritjen e gjykitimit. Po kështu, çështja nuk paraqet kompleksitet të veçantë. Pamundësia objektive në lidhje me ngarkesën e gjykatave nuk mund të jetë rrethanë për justifikimin e kohëzgjatjes së gjykitimit, qëndrim i mbajtur edhe nga Gjykata në vendimin nr. 2, datë 17.02.2022.

16. Neni 42 i Kushtetutës përcakton se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

17. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi e ka paraqitur kërkesën për konstatimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Lartë, 1 muaj e 14 ditë pas tejkalimit të afatit 2-vjeçar të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, dhe 6 muaj e 17 ditë deri në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykitimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës, kërkohet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë gjykitimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 25, datë 11.05.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ashtu sikurse pranohet edhe nga Gjykata e Lartë, kjo vonesë ka ardhur si rezultat i ngarkesës së madhe dhe akumulimit të dosjeve në këtë gjykatë ndër vite. Pas kërkesës së drejtuar nga kancelari i Gjykatës së Lartë, me shkresën nr. 6104 prot., datë 10.11.2022, gjyqtari relator ka parashtruar mendimin e tij me shkrim, duke argumentuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë po shqyrton çështjet e themelit të regjistruara në vitin 2014 që kanë kaluar për gjykim, në vijim të seleksionimit të tyre në dhomën e këshillimit. Aktualisht rezultojnë 656 çështje civile të vitit 2014. Gjyqtari relator, gjithashtu, ka argumentuar se për shkak të numrit të madh të çështjeve më të hershme në kohë, nuk mund t’i jepet përparësi shqyrtimit të çështjes së kërkuesit. Për më tepër, në lidhje me

çështjen e kërkuarit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nuk paraqiten shkaqe të veçanta për përshpejtimin e saj, që të prevalojnë mbi kriterin e radhës së regjistrimit, referuar vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit" dhe nenit 460 të KPC-së.

20. Nisur nga sa më lart, Kolegji vëren se kërkuari e ka lidhur cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm vetëm me kriterin e kalimit të afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, për shkak se Gjykata e Lartë ende nuk e ka shqyrtuar rekursin e tij kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim. Prandaj, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka paraqitur asnjë argument se si vonesa prej 1 muaj e 14 ditë pas tejkallimit të afatit 2-vjeçar nga paraqitja e kërkesës së tij për përshpejtim, dhe 6 muaj e 17 ditë deri në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual, në marrjen në shqyrtim të rekursit, i ka cenuar atij të drejtat e tij kushtetuese.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.